



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për Buxhet dhe Financa**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 28/08**

**Prishtinë, më 10.11.2008, ora 14:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203**

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

**Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj, Hajdin Abazi, Shkumbin Demaliaj, Xhevdet Neziraj. Müfera Şinik, Naser Osmani, Riza Smaka.**

**Anëtarët jo të pranishëm: Kosara Nikolić, Myrvete Pantina,**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Adrian Zalli, Vërshim Hatipi nga TKPK, Ali Hamiti, Ejup Hasolli, Nysret Avdiu nga ZRRE, Tek Shala nga NDI, monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, NDI, KDI.

**Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 22 tetor 2008**
- 3. Shqyrtimi i analizës nr. 03/1232/ Do-578/1 dt. 30.10.2008 me arsyeime për zbritjen e tarifës menaxhuese vjetore si dhe shqyrtimi i Raportit dt. 20.10.2008 të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për tremujorin e tretë të vitit 2008**  
**Të ftuar: Përfaqësuesit e menaxhmentit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës**
- 4. Shqyrtimi i kërkesës nr. 391108 dt. 23.10.2008 buxhetore të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2009**  
**Të ftuar: Përfaqësuesit e ZRRE-së**

5. **Shqyrtimi i Ligjit për taksën e akomodimit në objektet hoteliere e turistike me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente**
6. **Të ndryshme.**

**Kryesuesi**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

### **2. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 22 tetor 2008**

**Kryesuesi**, konstatoi se procesverbali nga mbledhja dt. 22 tetor 2008, miratohet pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i analizës nr. 03/1232/ Do-578/1 dt. 30.10.2008 me arsyetime për zbritjen e tarifës menaxhuese vjetore si dhe shqyrtimi i Raportit dt. 20.10.2008 të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për tremujorin e tretë të vitit 2008** **Të ftuar: Përfaqësuesit e menaxhmentit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës**

**Kryesuesi**, njoftoi se kërkesën trustit lidhur me miratimin e zbritjes së tarifës menaxhuese komisioni e ka shqyrtuar dhe ka dhënë rekomandimin e vet, por në seancë plenare me rastin e shqyrtimit të saj, Kuvendi me vendim ka kërkuar rishqyrtimin, duke kërkuar njëkohësisht edhe raport nga Trusti për gjendjen e investimit të mjeteve të kontribuesve kosovar. Bëri vërejtje për gjuhën teknike të përdorur në raport. Në vazhdim për sqarime të mëtutjeshme ua dha fjalën përfaqësuesve të menaxhmentit të trustit.

**Ardian Zalli**, duke i'u përgjigjur kryetarit për gjuhën e përdorur në raport, arsyeja e përdorimit të gjuhës se këtillë teknike, është përdorur për shkaqe të auditimit. Theksoi se në bazë të Ligjit, Bordi i trustit përgatit buxhetin dhe mëpastaj procedon në Kuvend për informim dhe njëkohësisht kërkon miratimin e tarifës menaxhuese e që në fakt edhe janë të hyrat buxhetore të trustit. Një procedurë e tillë është ndjekur nga trusti, ku është kërkuar ulja e tarifës në 0.8 %. Të hyrat e trustit planifikohen të jenë 2.2 milion euro për vitin 2009, ndërsa shpenzimet do të mbesin të njëjta.

**Vërshim Hatipi**, theksoi se në tabelat e prezantuara në raport është paraqitur gjendja e investimeve për nëntë muaj dhe është bërë një parashikim për tre muajt e fundit. Investimet e mjeteve trusti i bënë përmes palëve të treta, e që ngarkojnë buxhetin e tij me shpenzime administrative.

**Riza Smaka**, kërkoj të dijë për lartësinë e pagave të anëtarëve të menaxhmentit, të bordit të trustit. Pyeti se a janë të siguruara depozitat e parave të trustit. Bëri vërejtje që buxhetin e ka miratuar bordi pak para skadimit ta mandatit, dhe është dashur që të hapet konkursi te muaj para skadimit të mandatit të tyre. Pozicioni për sigurimin fiduciar shumë i lartë. Z. Smaka theksoi se në krahasim me kushtet ekonomike dhe sociale që po jetojnë qytetarët, pozicionet e trustit, në veçanti për pagat janë marramendëse.

**Naser Osmani**, theksoi se është dashur në raport të jepen informata më të specifikuar që të kuptohen më lehtë edhe nga jofinanciarët. Të pasqyrohen qartë shumat për paga, për numrin e punëtorë dhe kategoritë tjera. Me rastin e specifikimit të këtyre informatave, më të dhënat të

detalizuar për shpenzimet do të mund të bëheshin vlerësime për shkallën e tarifës menaxhuese. Informatat duhet të vijnë në bazë të plotësimit të formularëve të përcaktuara nga MEF-i.

**Shkumbin Demaliaj**, u pajtua me opinionet e z. Smaka, për të bërë specifikimin e buxhetit të bordit, lartësinë e pagave dhe kategorive tjera. Në këtë mënyrë do të krijoheshin kushtet për të votuar për arsyeshmërin e tarifës menaxhuese.

**Besa Gaxherri**, theksoi se ka paqartësi të shpenzimet, ka shumë konfuzion. Duam të dimë qartazi sa janë pagat dhe mëditjet, numri i punëtorëve, mallrat dhe shërbimet, sigurimi i mjeteve dhe të dhënat tjera të specifikuara dhe të detalizuara. Pas marrjes së këtyre informatave mund të vendosim për kuotën e tarifës menaxhuese.

**Safete Hadërgjonaj**, theksoi se raporti i detalizuar që është kërkuar nga Kuvendi duhet sqaruar në mënyrë që Komisioni të nxjerr një rekomandimin e vet i cili duhet të jetë më i sqaruar lidhur me çështjen në fjalë , përndryshe vendimi për tarifën menaxhuese nuk do të kalojë në seancë plenare.

**Haki Shatri**, informatat e paraqitura në raport nuk janë të mjaftueshme. Është dashur të kemi informata më të shumta për bordin udhëheqës, pagat, shpenzimet profesionale, mirëmbajtjen, auditimin. Në bazë të tarifës 0.4 %, buxheti i trustit do të arrijë shumën mbi 912.000 euro, ndërsa me tarifën 0.8 % do të arrijnë shumën prej 2.228.000 euro. Më pas pyeti çka paraqet shuma prej 1.300.000 euro?

**Vërshim Hatipi**, theksoi se kompenzimin e bordit e ka caktuar PSSP-ja. U pajtua me konstatimet se për kushtet dhe standardin e Kosovës ato shuma janë të larta, por ato kanë mbetur që nga atëherë.

**Haki Shatri**, kërkoi sqarime për të gjitha çështjet. Duhet sqaruar shifrat, para se të miratojmë kërkesën (tarifën menaxhuese).

**Hajdin Abazi**, konsideroi se të gjitha opinionet që u shprehën nga anëtarët, janë edhe shqetësime të qytetarëve të cilët janë të brengosur për mjetet e tyre. Duhet të dihet gjendja reale se si është. Sqarimet janë të domosdoshme dhe duhet të jenë të thjeshtësuara në mënyrë që edhe qytetarët të dijnë se çfarë është gjendja me mjetet e tyre. Duhet siguruar informacione me sqarime në mënyrë që të mund të votohet dhe të kalojë në Kuvend.

**Safete Hadërgjonaj**, u pajtua me mendimin se pas marrjes së të dhënave të detalizuara duhet trajtuar buxhetin e TKPK-së, në kuadër të kësaj të diskutohet edhe për tarifën menaxhuese.

**Naser Osmani**, theksoi se taksa menaxhuese i dikton shpenzimet në kategoritë menaxhuese.

**Kryesuesi**, interpretoi Ligjin e ri, në të cilin thuhet ku në të kaluarën buxhetin e TKPK-së e ka miratuar PSSP-ja, me ndryshimet e bëra buxhetin e përgatit bordi por e procedon në Kuvend për miratim e jo vetëm për informim. Buxheti miratohet së bashku me taksën menaxhuese. U interesua të sqarohet për numrin e punëtorëve, pozicionet e tyre, që të gjitha të pasqyrohen në buxhet.

**Besa Gaxherri**, theksoi se ky komision mund të luajë rolin e avokatit në Kuvend për çështjen e trustit, prandaj kërkohet prezantimi i shpenzimeve që të mund të përkrahët kërkesa për tarifën menaxhuese.

**Riza Smaka**, kërkoi sqarime më të shumta për zbritjen e tarifës menaxhuese 0.8 %, kur dihet se vitin që po hyjmë do të kemi një numër më të madhë pensionistësh. Posa ta ofrohen këto të dhëna do të krijoheshin kushtet për votim.

**Shkumbin Demaliaj**, kërkoi të kthehet mbrapa kërkesa për miratimin tarifës menaxhuese, dhe të kërkohet përgatitja e kërkesa buxhetore, parashikimi i gjitha shpenzimeve konform formularëve të përcaktuar nga MEF-i dhe të procedohet në Komision, pastaj për miratim në Kuvend.

**Naser Osmani**, për shkak të nevojave ligjore, për hirë të transparencës, kërkoi që të ofrohen informacione më të hollësishme, zberthim i tabelave, plani i shpenzimeve. Këto të dhëna do të ndikonin që Komisioni të nxjerr rekomandim të arsyeshëm, i cili mund të jetë bindës për deputetet në seancë me rastin e votimit për mjetet e trustit.

**Kryesuesi**, kërkoi që konform ligjit, trusti të përgatit planin e shpenzimeve sipas formularëve të MEF-it, në mënyrë që të mund të merret rekomandimi edhe për tarifës menaxhuese.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

## **REKOMANDIM**

- I. Kërkohet përgatitja dhe dorëzimi i raportit për shpenzimet e nëntëmujorit të vitit 2008 në bazë të formularëve standard të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave si dhe projeksionet buxhetore të TKPK-së për vitin 2009 në mënyrë që Komisioni të mund jap rekomandimet për seancë plenare.

### **4. Shqyrtimi i kërkesës nr. 391108 dt. 23.10.2008 buxhetore të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2009** **Të ftuar: Përfaqësuesit e ZRRE-së 2009**

**Kryesuesi**, njoftoi për plotësimin dhe zvogëlimin (prej 100.000 €) e kërkesës buxhetore të ZRRE-së.

**Safete Hadërgjonaj**, pyeti se me kërkesën e plotësuar sa kanë mbetur pagat e anëtarëve të bordit?

**Ali Hamiti**, për dallim prej kërkesës së parë kemi një zbritje prej 125.500 € Janë hequr dy projekte. Sa i përket pyetjes lidhur me pagat e anëtarëve të bordit, theksoi se ato kanë mbetur 1500 euro bruto, kjo për faktin se anëtarët e bordit do të kenë punë shtesë vitin e ardhshëm.

**Kryesuesi**, theksoi se sipas ligjit të ZRRE-së paga e anëtarëve të bordit duhet të jetë sa e deputetit, dhe jo siç ka qenë e rregulluar në bazë të mesatares së ndërmarrjeve publike. Zgjidhja më e mirë për këtë agjencion edhe për të tjerët do të ishte hyrja në fuqi e udhëzimit të Qeverisë rreth përcaktimit të pagave për të gjitha agjencionet buxhetore. Megjithatë duke ditur rëndësinë që ka ky agjencion, pagat duhet të jenë në nivelin e tregut që mbulojnë.

**Nysret Avdiu**, duke u ndërlidhur në diskutimet për paga, theksoi se me rastin e përcaktimit e tyre duhet merren parasysh karakteristikat e agjencionit, tregun që rregullojnë ato. Duhet bërë dallim në paga në mes shërbyesve civil.

**Riza Smaka**, u pajtua me mendimet që pagat duhet të jenë meritore. Duke komentuar kërkesën theksoi se duhet plotësuar ajo në mënyrë që të pasqyrohet rrjedha e shpenzimeve për vitin 2008, që të kemi një pasqyrë më të saktë për vitin 2009.

**Ali Hamiti**, për herë të parë kemi përgatitur kërkesën konform formularëve të MEF-it. Duke pasur parasysh fakti se procesi i përgatitjes së buxhetit ka përfunduar këtë vit nuk mund t'i fusim këto plotësime.

**Haki Shatri**, me disa modifikime në paga që mund të bëhen, për këtë kërkesë sikurse e kërkesat tjera do të vendosim me shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit të përgjithshëm.

**Ali Hamiti**, ekzistojnë disa vende të zbrazëta, brenda vitit ndoshta nuk mund të rekrutohen.

**Nysret Avdiu**, vitin e ardhshëm parashihet që ZRRE-ja të merr detyra shtesë nga procesi i privatizimit, siç është strategjia elektrike. Pyeti si Kuvend a kanë paraparë detyrat dhe përgjegjësitë konkrete, që shpenzimet e mundshme të mund të parashihen në buxhetin e ZRRE-së.

**Kryesuesi**, nëse parashihen detyra shtesë gjatë vitit të ardhshëm, me rastin e shikimit të buxhetit të përgjithshëm do të rishikohet edhe buxheti i ZRRE-së.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

## **P Ë R F U N D I M**

Kërkesa buxhetore e ZRRE-së për vitin 2009 do të miratohet me rastin e shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës.

### **5. Shqyrtimi i Ligjit për taksën e akomodimit në objektet hoteliere e turistike me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente**

**Kryesuesi**, theksoi se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore. Përveç amendamentit 4, në bazë të asaj që është shkruar, ekziston një dilemë lidhur me organin kompetent për vjeljen e taksës së akomodimit. Prandaj kërkoi sqarim nga anëtarët e këtij komisioni (z. Shatri dhe znj. Hadërgjonaj).

**Haki Shatri**, edhe pse mund të duket nga shkrimi amendamentit kjo dilemë, theksoi se ai ka propozuar që që Administrata Tatimore të jetë organi i vetëm kompetent për inkasimin e taksës së akomodimit. Ndërsa organet e turizmit janë kompetente për përcjelljen e zhvillimit të turizmit, t'i ofrojnë raporte ATK-së, në mënyrë që të ketë informacione për pagesën e kësaj takse nga kompanitë që merren me turizëm.

**Riza Smaka**, propozoi të riformulohet amendamenti 2 dhe amendamenti 4.

Amendamenti 2 që i referohet ndryshimit të Nenit 3.4 të Ligjit riformulohet si vijon:

Mjetet e grumbulluara nga taksa e akomodimit paguhen në llogari të Buxhetit të Republikës së Kosovës

Amendamenti 4 që i referohet ndryshimit të Nenit 8 riformulohet si vijon:

Administrata tatimore dhe autoritetet për punët e turizmit janë kompetentë për mbikëqyerjen e mbajtjes së evidencës përkatëse ndërsa administrata tatimore për arkëtimin e taksës së akomodimit

## 6. Të ndryshme

**Kryesuesi**, njoftoi se kemi dy kërkesa që nuk janë paraparë në rend dite njëra ka të bëjë me KPMK-në ndërsa tjetra me ish një deputet. Përfaqësuesit e KPMK-së kërkojnë transferim të mjeteve të brendshme për paga në formë shtesash, prej në mënyrë retroaktive nga muaji mars deri në fund të vitit. Duke pasur parasysh faktin se janë pjesë e Kuvendit, administrata e Kuvendit gëzon këtë të drejtë, prandaj edhe stafi i tyre duhet trajtohet njësojë. Hapi diskutimin për këtë çështje.

**Riza Smaka**, kërkoi që Komisioni të luaj një politikë konsekuente. Shifet se ka shumë kërkesa dhe paraqitet një lërmani e madhe. Kjo çështje duhet zgjidhur me Ligjin për paga.

**Safete Hadërgjonaj**, duke komentuar kërkesën pyeti se a kanë staf të madh, punë të shumta, që kërkojnë mjete shtesë.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

### REKOMANDIM

- I. Kërkesa e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës do të trajtohet me rastin e shqyrtimi dhe miratimit të buxhetit të Kuvendit të Kosovës në kuadër të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës për vitin 2009

**Kryesuesi**, kërkesa tjetër ka të bëjë me ish deputetin Ramadan Kelmendi i njofton se ka një problem shëndetësor dhe kurimi i të cilit duhet bërë jashtë vendit. Në mungesë të kushteve kërkon cili kërkon 2000 € ndihmë për të mbuluar shpenzimet për shërim. Paraprakisht është njoftuar nga Sekretari i Kuvendit se një kërkesë e tillë është parashtruar në Kryesi me një shumë prej 1500 € e cila është përkrahur. Prandaj kërkoi që Komisioni të konfirmojë vendimin e Kryesisë lidhur me rastin në fjalë.

Mbledhja përfundoi në ora 16:00

**Kryesuesi i Komisionit,**

---

**Gani KOCI**

**Përgatitur nga**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**